- Kutia te jete e mbyllur hermetikisht dhe e mbeshjtjelle me etikete te perkthyer ne gjuhen shqipe kur malli eshte i huaj.
- Permbajtja te jete salce dhe kripe.
- Perberja e mases te jete homogjene dhe me 18-20% lende e thate.
- Nuk lejohen perberes te tjere dhe lende te huaja.
- Ngjyra e salces te jete e kuqe e thelle.
- Shija te jete e embel pa shume aciditet.
- Aroma te jete e kendshme ne perputhje me aroren e domates se fresket karakteristike e llojit.
- Ne etikete te jete shenuar qarte firma prodhuese dhe ajo tregtuese. Kapaku te jete i mbyllur hermetikisht dhe me afatin e skadences.
- Te jete brenda afatit te skadences dhe sa me afer dates se prodhimit.
- Te jete i shoqeruar me fleteanalize
- **Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.**

Lloji i mallit : Kripe e jodizuar

Specifikimet teknike :

- Sasia e jodit nga 20 ppm (pjese per milion) deri ne 60 ppm
- Pamjamase e perhedhur dhe e perbere nga kristale te imta e te njellojta.
- Kokrrizat e kripes te jene te imet , ngjyra e bardhe me shkelqim ,pa trupa te huaj.
- Me shije karakteristike te kripur pa ere te huaj me perdorim te njetrajtshem e tretshme plotesisht ne uje
- Na Cl te jete 97%

-Lageshti jo me shume se 1 %

- Ambalazhuar ne qese plasmasi 0.5 kg- Te jete i shoqeruar me flete analize te leshuar nga organet kompetente shteterore .

- Te jete brenda afatit te skadences dhe sa me afer dates se prodhimit.

- **Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.**

Lloji i mallit: Çaj

Specifikimet teknike:

- Te jete i cilesise se pare, i thare mire dhe i ambalazhuar ne kuti kartoni 30 gr deri ne 100 gr.

- Te kete ngjyre uniforme, pa lende te huaja.

- Kutia e ambalazhit duhet te shprehe qarte te dhenat cilesore e teknike per mallin e kerkuar

- Te jete brenda afatit te skadences dhe sa me afer dates se prodhimit.

- **Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.**

Lloji i mallit :Kafe

Specifikimet teknike :

Te jene te fresket.Te ambalazhuar ne pako me peshe 100 gr pakoja te pademtuara.

Ne ambalazhim te kete te shenuar me etiket te qendrushme afatin e garancise si dhe prodhuesin.

Nuk perjashtohet dhe kerkesa e llojit te prodhimit. . Te jete brenda afatit te skadences dhe sa me afer dates se prodhimit.

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Lloji i mallit :Biskota

Specifikimet teknike :

Te jene te fresketa. Te pjekura mire me forme uniforme dhe porozitet te imet.Pa shije e ere te huaj.

Lageshtia ne % jo me shume se 8.Te ambalazhuar ne pako me peshe 250 gr pakoja te pademtuara.

Ne ambalazhim te kete te shenuar me etiket te qendrushme afatin e garancise si dhe prodhuesin.

Nuk perjashtohet dhe kerkesa e llojit te prodhimit. . Te jene brenda afatit te skadences dhe sa me afer dates se prodhimit.

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Lloji i mallit: Qepe e thate :

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare,te jete me pjekuri te plote,me cipe e bisht te thate,te shendosha e te plota,me ngjyre e forme tipike te kultivarit dhe me gjatesi te bishtit deri ne 7 cm.

-Madhesia e kokrrës per ovalet te jete mbi 5cm dhe per llojet e tjera 5-10 cm.

-Lejohen jo me shume se 1 % e partise me demtime te lehta dhe 1 % lende te huaja.

-Me semundje nuk lejohen.

-Te ngrira,te kalbura e te mykura nuk lejohen.

- **Duhet te jene te ambalazuara ne thase rrjete**

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Lloji i mallit : Patate :

Specifikimet teknike :

-Kerkohet cilesia e pare,te jete e plote,te forta,te pastra e te thata,jo jeshile,jo te mbira me ngjyre dhe me sytha tipike te kultivarit.

-Kokrra te jete e pjekur.

-Madhesia e kokrrës te jete per pataten dimerore mbi 5 cm dhe per ato verore mbi 4 cm.

-Nuk lejohen te gjelbera, te vyshkura, te mbira, te çara e te prera, te kalbura, zgjebe ne plage, njolla boje hiri e ndryshku, demtime nga krimbi, demtime nga dosa dhe te papastruara nga dherat.

-Duhet te jene te ambalazhuara ne thase rrjete 10 deri ne 25 kg.

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Lloji i mallit: Lakra

Specifikimet teknike :Lakra duhet te paraqese keto karakteristika

Pamja e jashtme: Kerkohet cilesia e pare, te jene te zhvilluara, me mbeshjtjellje fletesh, e forte ne prekje. Lejohen lakra te pa ngjeshura deri ne 5 % te partise. Te jene te pastra dhe me 2-3 gjethe te gjelbera, te lidhura me koçanin i cili tejete deri ne 3 cm. Lejohen deri ne 5 % e partise me demtime te lehta mekanike, te çara lehtesisht e te shperthyera si dhe te demtuara lehtesisht nga bryma. Me semundje nuk lejohen. Pesha e kokrrës te jete jo me pak se 1 kg per lakren e hershme dhe per pjekje te mesme e te vona jo me pak se 1.5 kg.

Te ambalazhuar ne arka kartoni ose plastike standarte 10 kg.

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara

Lloji i mallit: Spec

Specifikimet teknike :Kerkohet cilesia e pare

- Pamja e jashtme te jene te fresketa, te pastra, me forme e ngjyre tipike sipas varietetit, me bisht jo me te gjate se 3 cm. Gjatesia e varieteteve me forme te rrumbullaket nga 7 cm e lart.Per varietetet me forme te gjate gjatesia duhet te jete nga 8 cm e lart. Specat duhet te kene pjekje uniforme me ngjyre sipas varietetit. Shija te jete karakteristike e varietetit.

- Nuk lejohet perzierja e specave djegese me ato jodjegese.

- Lejohen demtime jo me shume se 3 %.

- Te jene te shoqeruara me fleteanalize.

Te ambalazhuar ne arka kartoni ose plastike standarte 10 kg.

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Lloji i mallit: Patellxhan

Specifikimet teknike :Kerkohet cilesia e pare

- Pamja e jashtme:te jene te fresketa, te pastra, me siperfaqe te lemuar, me ngjyre te zeze manushaqe, me shkelqim, me pjekuri normale. Me flete jeshile me nuance te dobeta manushaqe, te pa vyshkura.

- Madhesia: gjatesia deri ne 20 cm dhe diametri jo me shume se 5 cm. Gjatesia e bishtit jo me shume se 4 cm.

- Nuk lejohen patellxhan te mykur, pa bishta, te shtypur, me semundje, te papastra, te kalbur me demtime mekanike e te rudhura.

Te jene te shoqeruara me flete analize.

Te ambalazhuar ne arka kartoni ose plastike standarte 10 kg.

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Lloji i mallit : Domate

Specifikimet teknike : Kerkohet domate e cilesise se pare.

- Pamja e jashtme: domatet te jene te fresketa me forme tipike per llojin e domates, te plota, te pasterta, te pavrara, te pashtypura, pa kalbje e pa njolla prej djegjes se diellit, te pa prekura prej semundjeve e demtonjesve dhe pa bishta.
- Pjekuria e ngjyra : te jete normale me ngjyre te kuqe, lehtesisht ne roze dhe jeshile rreth bishtit.
- Nuk lejohen domate te tejpejekura, te zbutura e vyshkura.
- Te plasura ete vrara lehtesisht per llojet e mesme e te vona lejohet deri ne 5 % plasaritje rreth bishtit, por pa rrjedhje lengu.
- Madhesia e kokrrës te jete : per te hershmet 3-4 cm, per te mesmet e te vonat 7 cm.
- Te jene te shoqeruara me flete analize te leshuar nga organet kompetente shteterore .

E ambalazhuar ne arka kartoni standarte 10 kg.

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Lloji i mallit: Fasule

Specifikimet teknike :

- Treguesit shqisor: Pamja kokrra te shendosha e te plota.
- Ngjyra e bardhe, shija pa ere myku, lageshtira deri ne 15 %, thyeshmeria deri ne 13 %, lende te huaja deri ne 0.8 %, demtime nga insektet nuk lejohen.
- Amballazhimi ne qese 1 kg. Me etikete te firmes prodhuese .
- Data e skadences jo me pak se nje vit nga data e furnizimit.
- Te jete i shoqeruar me certifikate cilesie.
- **Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.**

Lloji i mallit: Purrij

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare,te jete i fresket,i njome,i paster,me gjyre te bardhe e jeshile,i pa vyshkur dhe i lare me uje te pijshem.

- Diametri ne pjesen me te trashe tejete mbi 2.5-3.5 cm.
- Gjatesia e kercellit te jete 25-45 cm.
- Gjatesia e gjethit nga rozeta te jete jo me shume se 20 cm.
- Sistemi rrenjor te jete jo me shume se 1 cm.
- Demtime e semundje nuk lejohen.

Te shoqerohen me flete analize.

I lidhur ne dengje jo me pak se 1 kg dhe i ambalazhuar ne arka kartoni ose plastike .

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Lloji i mallit: Spinaq

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesi e pare, i fresket , i njome, i paster me ngjyre jeshile te erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, i lidhur ne dengje te vogla deri ne nje kg.

- Me rrenje te prera
- Gjatesia e kercellit te mos jete me shume se 5 cm
- Te mos kete prani te barerave te tjera.
- Gjethet te jene te plota me gjeresi deri ne 10 cm dhe gjatesi e gjethes deri ne 20 cm.
- Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, pa demtime mekanike, te fresketa dhe te pavyshkuara.
- Te jete i shoqeruar me flete analize.
- **Te jete e e ambalazhuar ne arka kartoni ose plastike.**
- **Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.**

Lloji i mallit: Molla

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesia e pare,me forme,ngjyre e shije te kultivarit,pa deformime,me pjekuri teknike te njejte,te shendosha,te pastra,te zhvilluara normalisht,pa ere e shije te huaja.

- Lejohen edhe kokrra pa bisht,por pa difekte rreth bishtit.
- Madhesia e kokrres te jete jo me pak se 60 mm ne prerje ne gjatesi.
- Demtime te ndryshme mekanike lejohen deri ne dy njolla jo te zeza,te vogla,te lehta per kokerr.
- Nuk lejohen te krimbura.
- Njolla te shkaktuara nga dielli ne lekurenuk lejohen.
- Gunga ne lekure nuk lejohen.
- Njolla nga solucionet kimike ne siperfaqen e kokrres lejohet deri ne $\frac{1}{4}$ e siperfaqes se frutit.

E ambalazhuar ne arka kartoni ose plastike standarte 10 kg..

Malli te shoqerohet me certifikate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Lloji i mallit: Portokall

Specifikimet teknike :

Kerkohet cilesi e pare,i fresket,me zhvillim normal,te shendoshe e me bisht.Pra dhe mbas 15 janarit lejohet kokrra pa bisht,perkatesisht 5 & 20 %,me pjekuri teknike te plote.

- Ngjyra te jete karakteristike e kultivarit,e verdhe ne portokalli, me ere karakteristike dhe shije te embel ne te athet,pa shije te hidhur.
- Madhesia e kokrres te jete jo me pak se 7cm.
- Demtime mekanike nuk lejohen.
- Te prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen.
- Lende te huaja nuk lejohen.
- Gervishje ne siperfaqe,nuk lejohen.
- Zbutje te kokrrave,ngirije dhe lagie te siparfaqes se tyrenuk lejohen.

I ambalazhuar ne arka kartoni ose plastike standarte 10 kg.

Malli te shoqerohet me certificate cilesie sipas standarteve te miratuara.

Malli duhet te jete i fresket dhe i stines.

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca11

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti i I : “ Blerje buke “

Fond limit:

1 077 233 (nje milion e shtatedhjete e shtate mije e dyqind e tredhjete e tre) lekë pa TVSH dhe shumatorja e cmimeve per njesi 2951.3 (dy mije e nenteqind e pesedhjete e nje pike tre) leke pa t.v.sh

<i>Nr</i>	<i>Emertimi i artikullit</i>	<i>Njesia matese</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Loti I Bukë gruri 1 kg Rreze 0.75</i>	<i>kg</i>	<i>14673</i>

Loti i II “Blerje produkte mishi e bulmeti “

Fondi limit :

5 078 325 (pese milion e shtatedhjete e tete mije e treqind e njezet e pese) lekë pa TVSH dhe shumatorja e cmimeve per njesi 13913.2 (trembedhjete milion e nenteqind e trembedhjete pike dy) leke pa t.v.sh

Nr.	Emertimi i Artikullit	Njesia e matjes	Sasia
<i>1</i>	<i>Mish viçi</i>	<i>kg</i>	<i>3179</i>
<i>2</i>	<i>Mish pule</i>	<i>kg</i>	<i>1223</i>
<i>3</i>	<i>Kremviça</i>	<i>kg</i>	<i>1223</i>
<i>4</i>	<i>Qumesht lëng</i>	<i>litra</i>	<i>7337</i>
<i>5</i>	<i>Kos</i>	<i>litra</i>	<i>7337</i>
<i>6</i>	<i>Gjalp</i>	<i>kg</i>	<i>489</i>
<i>7</i>	<i>Djath I bardhe</i>	<i>kg</i>	<i>2446</i>

8	<i>Vezë</i>	<i>kokrra</i>	24455
---	-------------	---------------	-------

Loti i III; “ Blerje ushqime kolonjare dhe zarzavate “

Fondi limit

2 656 486 (dy milion e gjashteqind e pesedhjetë e gjashtë mijë e katerqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe shumatorja e cmimeve per njesi 7278 (shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tete) leke pa t.v.sh

Nr	<i>Emertimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Reçel</i>	<i>kg</i>	<i>1223</i>
2	<i>Miell</i>	<i>kg</i>	<i>489</i>
3	<i>Oriz</i>	<i>kg</i>	<i>2446</i>
4	<i>Sheqer</i>	<i>Kg</i>	<i>1223</i>
5	<i>Makarona</i>	<i>Kg</i>	<i>2446</i>
6	<i>Vaj gjelle</i>	<i>litra</i>	<i>1223</i>
7	<i>Salce</i>	<i>kg</i>	<i>245</i>
8	<i>Kripe e jodizuar</i>	<i>kg</i>	<i>367</i>
9	<i>Çaje</i>	<i>kg</i>	<i>49</i>
10	<i>Kafe</i>	<i>kg</i>	<i>122</i>
11	<i>Biskota</i>	<i>kg</i>	<i>245</i>
12	<i>Qepe e thate</i>	<i>kg</i>	<i>245</i>
13	<i>Patate</i>	<i>kg</i>	<i>3668</i>
14	<i>Lakra</i>	<i>kg</i>	<i>1345</i>
15	<i>Purrij</i>	<i>kg</i>	<i>1467</i>
16	<i>Spinaq</i>	<i>kg</i>	<i>611</i>
17	<i>Specë</i>	<i>kg</i>	<i>1223</i>
18	<i>Patlixhana</i>	<i>kg</i>	<i>611</i>
19	<i>Domate</i>	<i>kg</i>	<i>611</i>
20	<i>Fasule</i>	<i>kg</i>	<i>1223</i>
21	<i>Molle</i>	<i>kg</i>	<i>4891</i>
22	<i>Portokalle</i>	<i>kg</i>	<i>4891</i>

GRAFIKU I LËVRIMIT

<i>Nr</i>	<i>Emertimi i artikullit</i>	<i>Njesia matese</i>	<i>Menyra furnizimit</i>	<i>Afati furnizimit</i>	<i>Vend i dorezimit</i>
1	Loti I Bukë gruri 1 kg Rreze 0.75	kg	Sipas kerkeses ditore	Cdo dite Ora 8:00	Magazina e Spitalit Psiquatrik Shkoder

1. Dorezimi i artikullit do te behet:

- Çdo dite me karte-lemit te firmosur nga furnizuesi dhe pritesi sipas grafikut te levrimit nga Autoriteti Kontraktor.
- Ne fund te muajit plotesohet **“Flete-dalje fature tatimore”**,qe duhet te perputhet me sasite e furnizimeve te kryera me kartela-limit.

Dokumenti i mesiperm pritet nga furnizuesi dhe pas nenshkrimit te tij nga magazinieri mbart detyrimin per likujdim nga Autoriteti Kontraktor.

Grafiku u levrimit
(Produkte Mishi)

Sasia e mallit që kërkohet:

<i>Nr .</i>	<i>Emertimi i Artikullit</i>	<i>Njesia e matjes</i>	<i>Menyra e furnizimit</i>	<i>Afati i furnizimit</i>	<i>Vend i dorezimit</i>
1	Mish viçi	kg	Sipas kekrkese Autoritetit Kontraktor	Nje here ne tre dite	Magazina e Spitalit Psiquatrik Shkoder
2	Mish pule	kg	Sipas kekrkese Autoritetit Kontraktor	Nje here ne tre dite	Magazina e Spitalit Psiquatrik Shkoder
3	Kremviça	kg	Sipas kekrkese Autoritetit Kontraktor	Nje here ne tre dite	Magazina e Spitalit Psiquatrik Shkoder

1.Dorezimi i **artikullit mish** do te behet:

- Per çdo furnizim do te plotesohet fletedalje-provizore e firmosur nga pritesi i mallit sipas grafikut te levrimit nga Autoriteti Kontraktor.
- Ne fund te muajit plotesohet **“Flete-dalje fature tatimore”**,qe duhet te perputhet me sasite e flete-daljeve provizore dhe me firmosjen e saj nga magazinieri qe mbart detyrimin ligjor per realizimin e likujdimit nga Autoriteti Kontraktor .
- Çdo parti malli do te dorezohet i ndare ne kater pjese kryesore te cilat ne pjeset me te dukshme ,duhet te jene te vulosura me vulen e veterinare.

Grafiku u levrimit
(Bulmetra dhe nenprodukte)

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emertimi i Artikullit	Njesia e matjes	Menyra furnizimit	Afati i furnizimit	Vend i dorezimit
1	<i>Qumesht lëng</i>	<i>litra</i>	<i>Sipas kërkeses ditore</i>	<i>Cdo dite</i> Ora 8:00	<i>Magazina e Spitalit Psikiatrik Shkoder</i>
2	<i>Kos natyral</i>	<i>litra</i>	<i>Sipas kërkeses ditore</i>	<i>Cdo dite</i> Ora 8:00	<i>Magazina e Spitalit Psikiatrik Shkoder</i>
3	<i>Gjalp</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kërkeses</i> <i>Autoriteti kontraktor</i>	<i>Çdo tre dite</i>	<i>Magazina e Spitalit Psikiatrik Shkoder</i>
4	<i>Djath I bardhe</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kërkeses</i> <i>Autoriteti kontraktor</i>	<i>Çdo tre dite</i>	<i>Magazina e Spitalit Psikiatrik Shkoder</i>
5	<i>Vezë</i>	<i>kokrra</i>	<i>Sipas kërkeses</i> <i>Autoritetit kontraktor</i>	<i>Çdo tre dite</i>	<i>Magazina e Spitalit Psikiatrik Shkoder</i>

1.Dorezimi i artikujve te mesiper do te behet

a)Per çdo furnizim do te plotesohet fletedalje-provizore e firmosur nga pritesi i mallit .

b)Ne fund te muajit plotesohet “**Flete-dalje fature (tatimore)**”,qe duhet te perputhet me sasite e fletedaljeve provizore dhe qe ne momentin e nenshkrimit nga magazinjeri qender, mbart detyrimin ligjor per realizimin e likujdimit nga Autoriteti Kontraktor .

2. Kërkesa per furnizim do te behet:

-Per furnizimet ditore dhe dy ditore porosia ,per furnizimin e radhes ,do te merret ditën e furnizimit te fundit

-Per furnizimet e tjera ,realizimi i furnizimit do te behet mbeshtetur ne grafikun e percaktuar mesiperme.

**Grafiku u levrimit
(Ushqime kolonjare dhe zarzavate)**

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	<i>Emertimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Menyra furnizimit</i>	<i>Afati i furnizimit</i>	<i>Vend i dorezimit</i>
1	<i>Reçel</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kerkeses Autoriteti kontraktor</i>	<i>3 here ne muaj</i>	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
2	<i>Miell</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kerkeses Autoriteti kontraktor</i>	<i>3 here ne muaj</i>	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
3	<i>Oriz</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kerkeses Autoriteti kontraktor</i>	<i>3 here ne muaj</i>	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
4	<i>Sheqer</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kerkeses Autoriteti kontraktor</i>	<i>3 here ne muaj</i>	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
5	<i>Makarona</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kerkeses Autoriteti kontraktor</i>	<i>3 here ne muaj</i>	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
6	<i>Vaj gjelle</i>	<i>litra</i>	<i>Sipas kerkeses Autoriteti kontraktor</i>	<i>3 here ne muaj</i>	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
7	<i>Salce</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i>	<i>3 here ne</i>	<i>Magazina</i>

Dokumentat Standarde të Tenderit

			<i>kerkeses</i> <i>Autoriteti</i> <i>kontraktor</i>	<i>muaj</i>	<i>e Spitalit Psiquiatra</i> <i>Shkoder</i>
8	<i>Kripe e jodizuar</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i> <i>kerkeses</i> <i>Autoriteti</i> <i>kontraktor</i>	<i>3 here ne</i> <i>muaj</i>	<i>Magazina</i> <i>e Spitalit</i> <i>Psiquiatrik</i> <i>Shkoder</i>
9	<i>Çaje</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i> <i>kerkeses</i> <i>Autoriteti</i> <i>kontraktor</i>	<i>3 here ne</i> <i>muaj</i>	<i>Magazina</i> <i>e Spitalit Psiquia</i> <i>Shkoder</i>
10	<i>Kafe</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i> <i>kerkeses</i> <i>Autoriteti</i> <i>kontraktor</i>	<i>3 here ne</i> <i>muaj</i>	<i>Magazina</i> <i>e Spitalit</i> <i>Psiquiatrik</i> <i>Shkoder</i>
11	<i>Biskota</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i> <i>kerkeses</i> <i>Autoriteti</i> <i>kontraktor</i>	<i>3 here ne</i> <i>muaj</i>	<i>Magazina</i> <i>e Spitalit Psiquia</i> <i>Shkoder</i>
12	<i>Qepe e thate</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i> <i>kerkeses</i> <i>ditore</i>	<i>Cdo dite</i> <i>Ora 8:00</i>	<i>Magazina</i> <i>e Spitalit</i> <i>Psiquiatrik</i> <i>Shkoder</i>
13	<i>Patate</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i> <i>kerkeses</i> <i>ditore</i>	<i>Cdo dite</i> <i>Ora 8:00</i>	<i>Magazina</i> <i>e Spitalit</i> <i>Psiquiatrik</i> <i>Shkoder</i>
14	<i>Lakra</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i> <i>kerkeses</i> <i>ditore</i>	<i>Cdo dite</i> <i>Ora 8:00</i>	<i>Magazina</i> <i>e Spitalit</i> <i>Psiquiatrik</i> <i>Shkoder</i>
15	<i>Purrij</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i> <i>kerkeses</i> <i>ditore</i>	<i>Cdo dite</i> <i>Ora 8:00</i>	<i>Magazina</i> <i>e Spitalit</i> <i>Psiquiatrik</i> <i>Shkoder</i>
16	<i>Spinak</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas</i> <i>kerkeses</i>	<i>Cdo dite</i> <i>Ora 8:00</i>	<i>Magazina</i> <i>e Spitalit</i>

			<i>ditore</i>		<i>Psiquiatrik Shkoder</i>
17	<i>Speca</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kërkeses ditore</i>	<i>Cdo dite</i> Ora 8:00	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
18	<i>Patlixhana</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kërkeses ditore</i>	<i>Cdo dite</i> Ora 8:00	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
19	<i>Domate</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kërkeses ditore</i>	<i>Cdo dite</i> Ora 8:00	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
20	<i>Fasule</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kërkeses ditore</i>	<i>Cdo dite</i> Ora 8:00	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
21	<i>Molle</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kërkeses ditore</i>	<i>Cdo dite</i> Ora 8:00	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>
22	<i>Portokalle</i>	<i>kg</i>	<i>Sipas kërkeses ditore</i>	<i>Cdo dite</i> Ora 8:00	<i>Magazina e Spitalit Psiquiatrik Shkoder</i>

1.Dorezimi i artikujve te mesiper do te behet

- a)Per çdo furnizim do te plotesohet fletedalje-provizore e firmosur nga pritesi i mallit .
b)Ne fund te muajit plotesohet “Flete-dalje fature (tatimore)”,qe duhet te perputhet me sasite e fletedaljeve provizore dhe qe ne momentin e nenshkrimit nga magazinjeri qender,mbart detyrimin mbart detyrimin ligjor per realizimin e likujdimit nga Autoriteti Kontraktor .

2. Kërkesa per furnizim do te behet:

- Per furnizimet ditore dhe dy ditore porosia ,per furnizimin e radhes ,do te merret ditën e furnizimit te fundit
-Per furnizimet e tjera ,realizimi i furnizimit do te behet mbeshetur ne grafikun e percaktuar mesiperme.

Furnizimi me zarzavate do te jete me zarzavate te stines.

Afatet e lëvrimet: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

Ushqimet do te levrohen ne menyre periodike sipas kërkeses se Autoritetit Kontraktor per

periudhen 12 (dhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontrates dhe sipas kushteve të kontrates për zbatim.

Shtojca 13

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Dokumentat Standarde të Tenderit

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Dokumentat Standarde të Tenderit

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë

me ate te perkufizuar ne ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë

punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin

e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.

- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitësit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

